

DEKRET
Nr. 195, datë 8.4.2026

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 6, pika 1, dhe nenit 21, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Komandar i Urdhrit të Skënderbeut”
zotit Giulio Castriota Scanderbeg**

“Në vlerësim të meritave për mbajtjen gjallë të kujtesës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, si dhe të kontributeve të veçanta në aktivizimin jetëgjatë në mbështetje të veprimtarive të shtetit dhe të Diasporës Shqiptare në Itali”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj